

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 34, datë 31.03.2026

PËR
MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT
“INSIG” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 89, pika 9, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Drejtorisë të Administrimit të Riskut dhe Modeleve Financiare, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e mjaftueshmërisë së provigjoneve teknike të shoqërisë “INSIG” SH.A., siç paraqiten në 31 dhjetor 2025, sipas përllogaritjes së shoqërisë.
2. Miratimin e përfshirjes në pasqyrat financiare të shoqërisë për mbylljen e vitit financiar 2025 të provigjoneve teknike totale të konvertuara në lekë si më poshtë:

Provigjonet teknike në 31 dhjetor 2025	Lekë
Provigjone teknike të primeve e dëmeve bruto në total	2,311,996,296
<i>Provigjone teknike të primeve e dëmeve në total – pjesa e risiguruesve</i>	302,540,697
Provigjone teknike të primeve e dëmeve neto në total	2,009,455,599

3. Ngarkohet shoqëria për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Saimir TOLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Adela XHEMALI